

Skema e nëngrantimit është zbatuar në kuadër të projektit "**Siguria për Qeniet Njerëzore dhe Kufijtë – Luftimi i Kontrabandimit të Migrantëve në Ballkanin Perëndimor**", mbështetur nga Komisioni European

Zhvilluar në bashkëpunim me Grupin 484, Aleancën Qytetare (Mali i Zi), Shoqatën e Juristëve të Rinj Maqedonas, Vasa Prava (E drejta jote) Bosnje dhe Hercegovinë, Qendrën e Beogradit për të Drejtat e Njeriut, Programin për të Drejtat Civile në Kosovë dhe Këshillin Danez për Refugjatët

Organizata zbatuese e nëngrantit: **Informative Network and Active Citizenship**
Zona e zbatimit: Korça, Elbasani

Periudha e zbatimit: Gusht 2021-Dhjetor 2021

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në parandalimin e *smuggling* të migrantëve.

Objektivat specifikë të projektit janë:

1. Ngritja e kapaciteteve të mediave lokale për të raportuar kontrabandimin e migrantëve, e kryer nëpërmjet identifikimit të problemeve që hasin dhe nëpërmjet trajnimeve mbi çështjen me ekspertë të medias dhe ligjit.
2. Ndërgjegjësimi i publikut mbi efektet ligjore dhe shoqërore të fenomenit të kontrabandimit të migrantëve, e kryer nëpërmjet një fushate ndërgjegjësuëse me objektiv komunitetin lokal.

Rezultatet të cilat synohet të arrihen janë:

- a) Raport mbi vlerësimin e qasjes së gazetarëve ndaj problemit të *smuggling* të migrantëve
- b) Trajnim për ngritjen e kapaciteteve të gazetarëve mbi legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, impaktin e *smuggling* dhe reflektimin e lajmeve të tematikës në media
- c) Fushatë ndërgjegjësimi në mediat lokale mbi problemet e migracionit prej 3 muajsh, e cila do të përfshijë: intervista me ekspertë të migracionit dhe policë mbi të dhënat e migrimit të paligjshëm, histori të detajuara të *smuggling* të migrantëve, një video e shkurtër mbi *smuggling* të migrantëve në Shqipëri dhe mbrojtjen e tyre, infografika.